

**Përgjigje e Ankesës ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Kirurgji I dhe II, Mjekësi urgjente**

Tetovë, 11.04.2018

Ankesa ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Kirurgji I dhe II dhe Mjekësi Urgjente, u shqyrtua nga anëtarët e Komisionit recenzues në përbërje: prof. dr. Hysen Heta – kryetar, prof. dr. Arben Beqiri – anëtar dhe prof. dr. Sadi Bexheti – anëtar.

Komisioni Recenzues në përbërjen e sipërpërmendur pas shqyrtimit të ankesës vendosi si më poshtë::

Komisioni Recenzues konsideron që Ankesa e dorëzuar nga kandidati dr. sc. Prim. Bajram Kamberi është e pabazë dhe nuk është në pajtim me nenin 79 dhe 80 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014. Kjo për disa arsye:

1. Konkursi i shpallur nga Universitetin Shtetëror i Tetovës për lëndët Kirurgjia I, II dhe Mjekësi Urgjente është i shpallur për rizgjedhje të mësimdhënësit nga thirrja Docent në thirrje Profesor Inordinar për këto lëndë. Në dokumentacionin e dorëzuar kundër kandidati Dr.sci.Prim. Bajram Kamberi nuk ka dorëzuar dokumentin për thirjen docent si kusht i domozdoshëm për avancim në thirjen Profesor inordinar në këta lëndë.
2. Komisioni recenzues, pas Rishqyrtimit të dosjes së kandidatit dr. sci. Prim. Bajram Kamberi ka konstatuar se i njëjti në konkurs nuk ka dorëzuar Vendim për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore Docent.
3. Kandidati Doc. Dr.sci. Prim. Kastriot Haxhirexha ka dorëzuar Vendimin për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore Docent në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës dhe është në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e

Tetovës ku e ushtron veprimtarinë e tij mësimore për lëndët mësimore Kirurgji I dhe II, dhe Mjekësi Urgjente.

4. Konkursi i shpallur nga Universitetin Shtetëror i Tetovës për lëndët Kirurgjia I, II dhe Mjekësi Urgjente i dedikohet atyre mjekëve të cilët janë specialistë në fushën e Kirurgjisë ngaqë jo vetëm kirurgjia si lëndë por edhe Mjekësia Urgjente është ngushtë e lidhur me Kirurgjinë dhe kjo është arsyeja se përse kudo në botë shumica e pacientëve me gjendje emergjente fillimisht dërgohen në Repartet ose Klinikat e Kirurgjisë dhe më pastaj ata orientohen në ato Spitale ku do të bëhet trajtimi i tyre definitiv.
  
5. Kandidati dr. sci. Bajram Kamberi në Ankesën e tij thekson se pikët e shënuara në shtojcën tabelare të referatit për zgjedhje nuk janë shënuar në mënyrë të rregullt. Komisioni recenzues pas rishqyrtimit të shtojcës tabelare konstaton se vlerësimi me pikë i veprimtarisë arsimore-shkencore dhe veprimtarive tjera është kryer në përputhshmëri me Kriteriumet për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje në thirrje mësimore dhe në përputhshmëri me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga dy kandidatet për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Kirurgji I dhe II dhe Mjekësi Urgjente Komisioni Recenzues ka vlerësuar se :

1. Kandidati i propozuar për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore Doc. Dr. Prim. Kastriot Haxhirexha i ka plotësuar të gjitha kriteret si dhe numrin e duhur të pikëve për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore profesor inordinar dhe prandaj nga Komisioni recenzues edhe është propozuar për t'u zgjedhur në këtë thirrje.




## PROPOZIMI PËRFUNDIMTAR


Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, Komisioni recenzues në përbërje prof. dr. Hysen Heta – kryetar, prof. dr. Arben Beqiri – anëtar dhe prof. dr. Sadi Bexheti – anëtar, edhe njëherë Këshillit të Rektoratit i propozon që kandidati *Doc. Dr. Kastriot Haxhirexha* të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore profesor inordinar për lëndët mësimore Kirurgji I dhe II, Mjekësi urgjente.

### Komisioni recenzues

**Prof. dr. Hysen Heta**



**Prof. dr. Arben Beqiri**



**Prof. dr. Sadi Bexheti**

